

GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS

P. nr. 71/12

Data: 21 Nëntor 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Laura Liguori, si Kryesuese e trupit gjykues, gjyqtarja e Kosovës Fllanza Kadiu dhe gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Grzegorz Lewocki, zyrtar ligjor i EULEX-it, të asistuar nga procesmbajtësi Stephen Parkinson dhe përkthyesi Lekë Nimani në lëndën penale kundër:

N.C., A.D.1.,A.D.2.

Te gjithë të akuzuar sipas aktakuzës se PSRK-se, PPS. nr. 36/2011 te datës 13 Shtator 2011 te ushtruar ne gjykatë me 7 Tetor 2011 dhe me modifikimin e dispozitivit me 1 Mars 2012 të ushtruar në gjykatë me 5 Mars 2012 për veprat penale si në vijim te ndjekura sipas *detyrës zyrtare* me:

Akuza 1: Vrasja e rende ne shkelje te nenit 147 paragrafi 1 nen paragrafi 3, 9 dhe 11 i lidhur me nenin 23 te Kodit Penal te Kosovës (KPK-se) dhe veprës penale te **Tentimit te vrasjes se rende**, ne shkelje te nenit 147 paragrafi 1 nen paragrafi 3 dhe 11 i lidhur me nenet 20 dhe 23 te KPK-se (për te pandehurit **A.D.2.** dhe **A.D.1.**),

Akuza 2: Mbajtjes në pronësi, posedim, kontroll dhe përdorim te paautorizuar te armëve te zjarrit ne shkelje te nenit 328 (2) te KPK-se (për te pandehurit **N.C.** dhe **A.D.**)

Pas mbajtjes se shqyrtimeve kryesore qe ishin te hapura për publikun me 28 Shkurt 2012, 19 Mars 2012, 20 Prill 2012, 1 qershor 2012, 13 Korrik 2012, 11 Tetor 2012, 22 Tetor 2012, 8 Nëntor 2012, 12 Nëntor 2012, 16 Nëntor 2012 dhe 21 Nëntor 2012, seancave te fjalimeve përfundimtare te bëra nga prokurori publik Reshat Millaku dhe avokatëve mbrojtës Kosovare Kelmendi, Azem Vllasi dhe Gani Hoxha.

Pas këshillim – votimit te kolegjit te mbajtur me 21 nëntor 2012 në përputhje me nenin 388 paragarfi1, nenin 390 paragrafi 3 dhe nenin 392 te KPPK-se, shpall ne publik dhe ne prezencë te të akuzuarve, avokatëve te tyre mbrojtës dhe prokurorit te PSRK-se nxjerr si ne vijim:

AKTGJYKIM

AKUZA 1:

- 1) Përmbajtja e akuzës 1 është modifikuar duke fshirë fjalët: “N.C.” dhe i zëvendëson me fjalët “ **person i panjohur**”,
- 2) I akuzuari **A.D.1.** dhe **A.D.2.**, me shënime personale si me sipër, janë:

TË PAFAJSHËM

Sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se te akuzuarit **A.D.1.**,**A.D.2.** dhe “personi i panjohur” në bashkëpunim me te pandehurin B.H. dhe S.Q. për shkak të konfliktit ndërmjet tyre dhe N.B. dhe për shkak të shkëmbimit të fjalëve të ashpra dhe ngatërresës së **A.D.2.** me N.B. kanë vepruar në hakmarrje dhe me 28 Shtator 2007 rreth orës 00.10-00.20 **A.D.2.** ishte duke vozitur një **xxxxxxx** me numrat të regjistrimit **xxxxxxx** për në pompën e benzinës të X.Z., afër fabrikës së “Silkaporit” dhe i ka marrë te pandehurit **A.D.1.** dhe “personin e panjohur”, të cilët ishin të armatosur me AK-47. Me vone ai i voziti deri te ura e lumit Lepenc afër fshatit Soponicë ku te pandehurit **A.D.1.** dhe “personi i panjohur” kanë instaluar një pritë dhe janë fshehur prapa një rrethoje gjersa i pandehuri **A.D.2.** është larguar nga ai vend. Në baze të marrëveshjes, B.H. dhe S.Q. në veturën **xxxxxxx**, e cila ishte prone e te pandehurit A.D., e ka vëzhguar momentin kur N.B. ka shkuar te makina e tij në drejtim të shtëpisë dhe duke vozitur pranë makinës së tij i ka rënë burisë 2-3 here tek ura mbi lumin Lepenc dhe me anë të këtij gjesti ai e ka njoftuar **A.D.1.** dhe “personin e panjohur” që ajo veturë me N.B. është duke u afruar. Kur N.B. me veturën e tij **xxxxxxx** me numrat e tabelave **xxxxxxx** është afruar afër urës, **A.D.1.** dhe “personi i panjohur” kanë hapur zjarr nga armët automatike në drejtim të makinës dhe kanë shkaktuar vdekjen e N.B., S.B. dhe U.B., e kanë plagosur rëndë B.B. dhe nuk i kanë shkaktuar lëndime S.B., të cilët po ashtu ishin në veturë.

PRANDAJ, i akuzuari **A.D.1.** dhe **A.D.2.** janë:

LIRUAR NGA AKUZA

Për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 147 paragrafi 1 nën paragrafi 3, 9 dhe 11 i lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale të tentimit të vrasjes së rëndë në shkelje të nenit 147 paragrafi 1 nën paragrafi 3 dhe 11 i lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së.

AKUZA 2:

Të akuzuarit **A.D.1.** dhe **N.C.** me shënimet personale si me sipër janë:

TË PAFAJSHËM

Sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se te akuzuarit **A.D.1.** dhe **N.C.**, me 27 dhe 28 Shtator 2007, secili prej tyre ka poseduar dhe ka mbajtur armën automatike AK-47 të kalibrit 7.62mm, pa leje mbi mbajtje të armës.

PRANDAJ, i akuzuari **A.D.1.** dhe **N.C.** janë:

LIRUAR NGA AKUZA

Për kryerjen e veprës penale të mbajtjes në pronësi, posedim, kontroll dhe përdorim të armëve të zjarrit në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 2 të KPK-se.

Arsyetim

Kompetenca e Gjykatës

Pas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria, Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it ia caktoi rastin një gjyqtari të EULEX-it për procedurat e konfirmimit dhe pastaj një paneli të përzier të gjykatësve ndërkombëtarë dhe vendorë për të kryer gjykimin kryesor.

Historia procedurale

Seanca e konfirmimit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) më 7 tetor 2011 ngriti një aktakuzë kundër tre të pandehurve, të akuzuar për veprat e sipërpërmendura. Gjyqtari i procedurës paraprake nga EULEX-i, i emëruar në seancën e konfirmimit të aktakuzës, e refuzoi aktakuzën për të gjithë prej tyre. Ai konsideroi se nuk kishte prova të mjaftueshme kundër të pandehurve, pasi që akuzat ishin bazuar vetëm në deklaratat e dhëna nga B.H. dhe S.Q., të cilat nuk janë mbështetur nga prova të tjera apo çfarëdo dëshmie tjetër.

Prokuroria paraqiti ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe Paneli i ankesave pjesërisht ia aprovoi atë. Paneli konfirmoi vendimin që e lironte nga aktakuza N.C. lidhur me akuzën një, pasi që ai kishte qenë i liruar nga akuza e njëjtë nga një panel prej tre gjyqtarësh ndërkombëtarë gjatë shqyrtimit kryesor kundër tij, B.H. dhe S.Q. dhe kjo ishte një rast i "ne bis in idem" ose një rast i rrezikut të dyfishtë. Paneli i ankesave e aprovoi ankesën e Prokurorisë kundër aktvendimit të konfirmimit për **N.C.** (akuza dy), **A.D.1.** dhe **A.D.2.** dhe lëshoi një vendim të konfirmimit të aktakuzave të lartpërmendura.

Gjetjet e shqyrtimit kryesor

Shqyrtimi kryesor filloi më 28 shkurt 2012 para trupit gjykues të përbërë nga gjyqtari kryesues ndërkombëtar, një gjyqtar ndërkombëtar dhe një gjyqtar vendës si anëtarë të panelit dhe përfundoi më 21 nëntor 2012. Në praninë e të akuzuarve, mbrojtjes së tyre dhe palëve të dëmtuara, më 28 shkurt 2012 kryetari i trupit gjykues ka konfirmuar se trupi gjykues ka qenë i përbërë në pajtim me ligjin. Gjatë seancës së njëjtë, padia u lexua nga prokurori publik; u pyetën të pandehurit që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tyre dhe ata nuk e pranuan fajin.

Gjatë shqyrtimit kryesor janë marrë në pyetje këta dëshmitarë:

S.B., B.B., Y.B., H.B., M.B., A.B. (20 prill 2012), R.M., N.A., B.H., F.H., A.H. (4 qershor 2012), M.D., A.K., S.D., N.K. (13 korrik 2012), A.A. (22 tetor 2012), B.H. (8 nëntor 2012) F.H. dhe M.Q. (12 nëntor 2012).

Këto dokumente janë marrë parasysht dhe janë pjesë e dosjes së lëndës:

- Raporti i autopsisë i N.B.;
- Raporti i autopsisë i S.B.;
- Raporti i autopsisë i U.B.;
- Raporti i policisë për viktimën e lënduar B.B. kundër të dyshuarve: S.Q. dhe N.C.;
- Kallëzimi penal i shqyrtimit i 21 nëntorit 2007;
- Harta e vendit të ngjarjes;
- Raporti i mjekësor nga zyra e ekzaminimit për N.B.;
- Raporti i mjekësor nga zyra e ekzaminimit për S.B.;
- Raporti i mjekësor nga zyra e ekzaminimit e 29 shtatorit 2007;
- Fotokopjet e fotografive të veturave;
- Koleksioni i fotografive dhe përshkrimi i fotografive.

Dokumentet e paraqitura nga mbrojtësit e të akuzuarit N.C.

1. AKTAKUZA PPS nr 41/09, datë 14.09.2009, e nënshkruar nga prokurori Reshat Millaku, në bazë të të cilit ishte gjykuar rasti i vrasjes së rëndë nga neni 147 i KPK-së, duke gjetur se N.B., U.B. dhe S.B. ishin vrarë; Tentim vrasje e rëndë në fshatin Soponice, më 27-28 shtator të vitit 2007 dhe posedim ilegal të armëve nga neni 328 i KPK-së, gjendet në shkresat e lëndës P.nr. 459/209, të datës 7 shkurt 2011;
2. AKTGJYKIMI i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P.Nr. 459/2009, datë 7 shkurt 2011, ku B.H. dhe S.Q. janë shpallur fajtorë për veprën penale nga neni 147 dhe për veprën penale nga neni 328, të dënuar me 33 vjet burgim, ndërsa N.C. ishte liruar nga akuzat.
3. ANKESA PPS.Nr 36/2011, datë 26.05.2011 e nënshkruar nga Prokurori Reshat Millaku, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në dosjen e rastit të njëjtë.
4. AKTGJYKIMI Ap-Kz. Nr. 264/2011, datë 12 tetor 2011, përmes së cilës u hodh poshtë Ankesa dhe u vërtetua në tërësinë e saj Aktgjykimi i shkallës së parë.
5. ANKESA PPS.Nr. 36,2011, datë 02.12.2011, të nënshkruar nga Prokurori Reshat Millaku kundër Aktgjykimeve të lartpërmendura të gjykatave të shkallës së parë dhe ato të shkallës së dytë. E vendosur në dosjen e çështjes Ap.-Kz.nr. 2.12.
6. AKTGJYKIMI Ap-Kz. Nr. 2/2012 i panelit të ankesave të shkallës së tretë, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është shpallur më 24 shtator 2012, por kjo nuk iu është dërguar ende palëve me shkrim. Ajo gjendet në shkrimoren e gjykatave nën numrin e dhënë. Nëpërmjet këtij Aktgjykimi, ankesat e mbrojtësve të B.H. dhe S.Q. ishin hedhur poshtë dhe Aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë ishin vërtetuar në tërësinë e tyre. Ankesa e Prokurorit kundër vendimit të pafajësisë për N.C. ishte hedhur poshtë si e paligjshme.

7. AKTGJYKIMI i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 26 shtator 2009, trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtari i EULEX-it Francesco Florit, lidhur me shpërthimin e ndodhur në Bulevardin Bill Klinton, në Prishtinë, në natën e 23-24 shtatorit të vitit 2007, me të cilin B.H. dhe S.Q. u shpallën fajtorë dhe u dënuan me 25 vjet burgim, ndërsa N.C. ishte liruar nga akuzat. Ky Aktgjykim tani është konfirmuar edhe në shkallë të dytë. Vendimi për lirimin e N.C. është i gjithëpushtetshëm. Ky aktgjykim është interesant në lidhje me zbulimin e motiveve për vrasjen që ndodhi tre ditë më vonë në fshatin Soponicë, e cila është duke u gjykuar tani, dhe këto motive janë shpjeguar në Aktakuzën PPS. Nr. 41/09, datë 14 shtator 2009.

Në fjalimet e tyre përmbyllëse Prokurori argumentoi që të pandehurit të gjenden fajtorë, palët e lënduara e mbështetën kërkesën e Prokurorit, Avokati mbrojtës argumentoi që aktakuzat të hidhen poshtë.

Faktet

Viktimat u sulmuan nga pusia në natën mes 27 dhe 28 shtatorit 2007, kur ata ishin në një xxxxxx të N.B.. Ata posa kishin dalë nga restorant Mani dhe ishin duke shkuar në drejtim të fshatit të tyre, në xxxxxx. Posa arritën në afërsi të xxxxxxxxxxxx, ata u kthyen në kthesën në të majtë, që çonte në fshatin xxxxxx. Ata ishin sulmuar derisa ata ishin duke kaluar urën mbi lumin Lepenc, ashtu siç kanë deklaruar palët e dëmtuara S.B. dhe B.B. në Gjykatë¹.

Një breshëri plumbash nga pushka automatike ishte shtënë në drejtim të veturës dhe personave që gjendeshin në të nga ana e djathtë e rrugës. Shtihej me dy armë automatike në të njëjtën kohë, sipas asaj që i kujtohej B.B. dhe sipas ekspertizës balistike që i është bashkangjitur shkresave të lëndës (njëra nga armët ishte një AK-47). Të shtënat ndodhën rreth orës 00.10 të datës 28 shtator 2007². Si pasojë e të shtënave N.B., S.B. dhe U.B. vdiqën, B.B. u plagos rëndë dhe S.B. mbeti i palënduar.

N.B. ishte personi i parë që kaloi afër vendit të ngjarjes, pas të shtënave. Ai ishte një i afërm i B.B.³ dhe rastësisht po udhëtonte në urë, kur ngjarja posa kishte ndodhur. Ai e pa veturën e viktimave të pozicionuar në urë dhe nuk u ndal, pasi ai nuk e dinte se çfarë po ndodhte. B.B., pavarësisht plagëve të tij, arriti ta shihte atë dhe i bëri një telefonatë në mënyrë që të kërkonte nga ai që të kthehej përsëri. Dëshmitari u kthye përsëri brenda pak minutash. Një nga patrullat e Policisë që ishte alarmuar për të dhënë mbështetje në vendngjarje udhëhiqej nga R.M.⁴, i cili gjatë rrugës u takua me një veturë xxxxxx në kryqëzimin me rrugën Soponica. B.H. ishte në makinë me një burrë tjetër⁵. Oficeri i policisë e ndaloi veturën, pa kolegun e tij B.H. dhe i tregoi atij se çfarë kishte ndodhur, dhe pastaj e la veturën të shkojë.

¹ Shih deklaratat e dhëna nga S.B., B.B. gjatë seancës së mbajtur më 20 prill 2012.

² Shih deklaratat e dhëna nga S.B., B.B., Y.B., M.B., A.B. gjatë seancës së mbajtur më 20 prill 2012.

³ Shih deklaratat e dhëna nga B.B. gjatë seancës së mbajtur më 20 prill 2012.

⁴ "Ne e tejkaluam automjetin në mes të Udhëkryqit të Flamurit dhe Urës së Sllatinës dhe veturën që e tejkaluam ishte xxxxxx, me ngjyrë xxxxxx. Para se të arrinim në sheshin të Udhëkryqit të Flamurit për një çast të shkurtër patëm idenë për ta ndaluar veturën, sepse rruga prej nga vinte vetura mund të çonte në vendin e ngjarjes. Kjo veturë erdhi gjithashtu në sheshin e Udhëkryqit të Flamurit menjëherë pas nesh dhe rreth 50 metra para sheshit ne e ndalëm këtë automjet dhe si oficerë të policisë dolëm nga automjeti dhe shkuam në drejtim të këtij automjeti dhe kur arrita aty e pashë se shoferi i automjetit ishte kolegu im B.H. së bashku me një person tjetër, një udhëtar, por unë nuk e mbaj mend se kush ishte".

⁵ Shih deklarata e N.A., seanca e mbajtur më 4 korrik 2012.

Hetimi i parë i kryer nga prokuroria përfundoi me një aktakuzë të ngritur nga Prokuroria ndaj B.H., S.Q., N.C., të akuzuar për vrasje të rënda dhe tentim vrasje. B.H. dhe S.Q. u shpallën fajtorë, ndërsa N.C. ishte liruar në një aktgjykim që ka marrë formë të prerë para përfundimit të këtij gjykimi kryesor⁶.

Pas lëshimit të aktgjykimit nga trupi gjykues i shkallës së parë në rastin kundër B.H., S.Q. dhe N.C. (vendimi i lëshuar më 7 shkurt 2011), Prokuroria filloi një hetim të ri lidhur me veprat e njëjta penale (Shih ROI) kundër N.C., A.D.1. dhe A.D.2., bazuar në deklaratat e dhëna nga S.Q. dhe B.H. dhe të cilët, mes të afërmeve të tyre, kishte folur me ta.

Në pjesën në vijim të arsyetimit do të shqyrtohen provat e mbledhura gjatë seancave dhe relevante për secilin prej të pandehurve dhe rolin e tyre në vrasjen.

Aktakuza dhe roli i N.C..

Që nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor paneli ka qenë duke u marrë me çështjen e aktakuzës së paraqitur nga Prokuroria dhe e kundërshtuar nga avokati mbrojtës. Përkundër vendimit të lëshuar nga Gjyqtari i konfirmimit i emëruar në këtë rast më 1 nëntor 2011 dhe i konfirmuar nga Paneli i Ankesave më 20 janar 2012, ku u theksua se N.C. nuk mund të ngarkohet me akuzën 1 sepse ajo ishte ose një rast i rrezikut të dyfishtë ("*ne bis in idem*") ose një rast i dyfishtë që kishte mbetur pezull (*listispendentia*). N.C. ishte i akuzuar me akuzën 1 të aktakuzës së paraqitur nga Prokuroria. Para fillimit të këtij shqyrtimi kryesor N.C. ishte liruar për vrasje dhe tentim vrasjeve nga ana e Gjykatës Supreme, e cila kishte lëshuar vendimin e saj më 12 tetor 2011. Në vendimin e Panelit të Ankesave theksohet se aktakuza e ngritur nga Prokuroria ishte një shkelje "në parimin e rrezikut të dyfishtë (*ne bis in idem*) në qoftë se vendimi i Gjykatës Supreme i 12 tetorit 2011 është një vendim i formës së prerë i akuzës për vrasje të rëndë kundër N.C.. Përndryshe, nëse vendimi i Gjykatës Supreme konsiderohet si një vendim i gjykatës së shkallës së dytë në pajtim me Kapitullin XXXVII të KPPK-s, kjo aktakuzë është një çështje e rasisit të mbetur pezull dyfish. (*listispendentia*)⁷. Duke marrë parasysh këtë vendim kolegji lëshoi një vendim përmes së cilit e fton Prokurorin për ndryshimin e aktakuzës në përputhje me rrethanat, por Prokurori e fshiu vetëm emrin e të pandehurit N.C. dhe nuk e ndryshoi përmbajtjen e aktakuzës, që u la ashtu siç ishte me referencë të veçantë për rolin e luajtur prej tij në veprat penale .

Çfarëdo dyshimi në vendimin e lëshuar nga Gjykata Supreme më 12 tetor 2011, nëse ishte i formës së prerë apo jo, është zgjidhur përfundimisht para përfundimit të këtij gjykimi, për shkak se më 24 shtator 2012 Gjykata Supreme, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Avokatët Mbrojtës dhe Prokurorit kundër tij, e hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga Prokuroria për sa i përket lirimit të të pandehurit N.C.. Edhe pse ky vendim përfundimtar ishte lëshuar para përfundimit të këtij gjykimi kryesor, Prokuroria mbeti në qëndrimin e tij dhe bëri referencë për të pandehurin si njëri nga "autorët" e veprave penale, gjatë fjalës së tij përmbjllëse, gjithashtu. Jo vetëm që kjo zgjedhje i bën palët e dëmtuara të hutohen dhe fare nuk e sqarojnë çështjen, por ajo

⁶ Shih vendimin e lëshuar nga Gjykata Supreme më 24 shtator 2012, e dor zuar nga avokati mbrojtës i N.C. dhe i pranuar si dokument relevant nga trupi gjykues.

⁷ Shih aktvendimin e Panelit të Ankesave më 20 janar 2012.

ishite mungesë respekti për dispozitat e nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), neni 34 i Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 4 të Protokollit shtesë numër 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) të 22 nëntorit 1984. Për këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv për të ndryshuar Akuzën 1 të aktakuzës duke fshirë fjalët "N.C." dhe zëvendësimin e tyre me "person i panjohur".

Dëshmia e B.H. dhe S.Q.

Hetimet e kryera nga PSRK-ja në veprat penale që kanë ndodhur në natën ndërmjet 27 dhe 28 shtatorit 2007 rezultoi në një aktakuzë të ngritur kundër B.H., S.Q. dhe N.C.. Një panel ndërkombëtar prej tre gjyqtarësh i emëruar në gjyqin e shkallës së parë e shpalli B.H. dhe S.Q. fajtorë, i dënnoi ata me një burgim afatgjatë prej 33 vitesh (dënim i përgjithshëm) dhe liroi N.C. siç u tha më parë. Pas shpalljes së aktgjykimit B.H. dhe S.Q. vendosën të flisnin me Prokurorin dhe t'i thonin atij se çfarë kishte ndodhur me të vërtetë gjatë "natës kritike" në urën e Lepencit. Deklaratat e tyre rezultuan në një hetim të ri nga ana e Prokurorisë dhe në të njëjtat akuza të ngritura ndaj A.D.1. dhe A.D.2., së bashku me N.C..

Sipas B.H. (i marrë në pyetje gjatë seancës së mbajtur më 8 nëntor 2012) i ndjeri N.B. nuk kishte mundur të siguronte që N.K. do t'ia kthente A.K. një shumë të hollash. Vetura që A.K. e kishte blerë nga N.K. iu ishte kthyer përsëri shitësit, për shkak se mungonin disa letra. N.B. kishte garantuar se N.K. do t'ia kthente paratë A.K., por pasi që A.K. nuk kishte marrë asgjë, N.B. ishte në telashe serioze. Shumë njerëz kanë qenë të përfshirë në këtë çështje, e cila kishte qenë temë e disa bisedave në mesin e një grupi të njerëzve vetëm para ngjarjeve të natës kritike⁸. Sipas njohurive të B.H., A.D.2. dhe A.D.1., ishin të pranishëm kur borxhi ishte diskutuar dhe ishte e qartë se i ndjeri N.B. ishte në telashe serioze me dikë që kishte marrë besimin e A.K.. Dëshmitari tha se ajo ishte arsyeja pse N.B. u vra dhe se të dy të pandehurit morën pjesë në vrasjen e N.B. së bashku me U.B. dhe S.B., të cilët rastisën të ishin bashkë me të në të njëjtën veturë, në tentim vrasjen e B.B. dhe S.B., të cilët gjendeshin në veturë gjithashtu⁹.

⁸ Shih faqet 3/5 të procesverbalit të seancës së mbajtur më 8 nëntor 2012.

⁹ M. dhe unë shkuam në xxxxxxx. I bleva dy palë këpucë për xxxxxxx dhe u kthyem te restorant Evropa. Atje A.K., A.D.2., A.A. dhe A.D.1. ishin ulur brenda në restorant. M. dhe unë shkuam dhe iu bashkuam atyre. Në ndërkohë N.C. erdhi aty nga një dhomë e hotelit. Ai iu afrua tavolinës sonë dhe na përshëndeti dhe e pyeti A.D.2., "A i ke përgatit gjërat? Dhe ai gjithashtu e pyeti: "A e ke parë atë mutin?" duke iu referuar N.B.. A.D.2. ishte duke e ngrënë një sanduiç dhe i tha, 'Ngadalë, ka ende kohë.' Ai tha: 'Më mirë nisu, sepse unë do ta qij nënën ty, ose nënën e A. apo atij tjetrit.' A.D.2. e la ushqimin dhe u ngrit dhe u largua së bashku me A.D.1. A.K. me telefonin e tij në dorë u largua pak duke qeshur me ironi. M. dhe unë e pyetëm N.C., "Pse po e fut veten në mut?" duke iu referuar A.. Kur erdha në Restorant Evropa ishte ora pas 20:00. N.C. më vonë vazhdoi dhe shkoi përsëri në dhomën e hotelit. I lashë ata prapa. M., A. dhe unë shkuam në fermën e deleve për të çuar ca ushqim për qentë. Punëtori i fermës, i quajtur F.C., e mori ushqim nga unë. Unë u ktheva përsëri në Restorant Evropa dhe unë nuk i takova asnjë nga shokët atje. Nga atje shkova në xxxxxxx. A.A. dhe M.D. arritën dhe në ndërkohë A.D.2., dhe A.D.1. arritën shpejt. Më vonë A.K. erdhi si dhe N.C., duke hyrë nga supermarketi. Ne të gjithë u ulëm në të njëjtën tavolinë dhe aty ishte vendi ku ata i caktuan detyrat apo rolet. Fillimisht N.C. e pyeti A.D.2., "A e ke parë atë copë muti?" Ai u përgjigj: "Po, ai është në Restorant Mani." Ai i tha M. që të shkojë në restorant Mani. N.C. u ngrit dhe i tha A.D.2., dhe A.D.1. që të vinin te Pompa e Benzinës xxxxx. Ata u nisën së bashku me A.D.1. Unë e di se në atë kohë A.D.2. nuk ishte shumë i kënaqur, A.D.1. nuk tha gjë, as në restorantin Evropa as atje. Ata vazhduan më vonë, A. dhe N.C. u larguan dhe ne pesë prej nesh qëndruam ulur në të njëjtën tavolinë. Ka mundur të jetë pas orës 22:00. Menjëherë pas A.D.2. na pyeti nëse mund ta çonim deri te Pompa e Benzinës Xhafa, në mënyrë që ai të kthehej me automjetin e tij. A.D.2. po e ngiste në rrugën për në pompën e benzinës, ai na çoi atje. A.D.2. dhe A.D.1. dolën nga automjeti dhe unë dola në ulësen e pasagjerit. Në pompë të benzinës u takova me N.C.. Ne ishim shumë afër. Ai ishte me automjetin e tij xxxxxx. Unë pashë atë duke i marrë nga bagazhi i veturës dy armë kallashnikov të mbështjellura me një xhakë sportive ngjyrë të errët. E luta A.D.2., "Mos nxito." Ai i ngriti duart, pastaj A. tha - nuk mund të bëj asgjë. Unë vet, T. dhe A. u kthyem prapa. Ndërsa ne ishim në Picerinë IDA, unë nuk e di se kush e pyeti N.C., "Pse me armë?" M. dhe unë, të dytë i thamë: "Nëse me të vërtetë mendoni, ne mund të dalim dhe ta rrahim atë në publik. Ai u përgjigj, "Unë e di se ai kurrë nuk ecë me armë me vete atë dhe unë do ta rrah sa që do të ketë nevojë për karrocë." Kur u kthyem nga Pompa e Benzinës Xhafa drejt Restorant Mani i kërkova M. që të më çonte te Ida Petrol, sepse unë kisha për tu takuar me një shok timin. Ata më zbritën te pompa e benzinës dhe vazhduan drejt Restorant Mani. Në ndërkohë S.Q. më thirri apo unë i telefonova atij, nuk e mbaj mend, që të vinte dhe të takohej me mua. M. dhe A. u kthyen përsëri në pompën e benzinës. Gjersa isha ulur me M., A. dhe me një shok tjetër, arriti S.Q. U largova nga tavolina që të shkoja të ulesha në një tavolinë tjetër me S.Q. Në ndërkohë M. dhe A. u larguan nga tavolina dhe M. erdhi te tavolina ime dhe i la në tavolinë çelësat e veturës xxxxxxx që i përkiste A.D.2. dhe kërkoi që t' i çonim të njëjtat çelësa te Restorant Evropa, sepse automjeti i M. ishte i parkuar në parking. Vetëm pas orës 23:00 N.C., më thirri. Nuk jam i sigurt nëse unë e thirra atë, apo ai më

Ai shpjegoi se çfarë kishte bërë ai dhe S.Q. atë natë dhe se çfarë e pasoi këtë ngjarje¹⁰. Pastaj B.H. i shpjegoi Gjykatës se çfarë kishte ndodhur gjatë paraburgimit.

Pastaj B.H. shpjegoi në Gjykatë se çfarë kishte ndodhur gjatë paraburgimit të tij në burgun e Dubravës dhe në përpjekje për të hedhur dritë mbi veprat penale për të cilat ai ishte akuzuar dhe më pas ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës. Ai ka rikujtuar takimin me disa të afërm të tij, me **A.D.2.** dhe çfarë i pandehuri i tha atij se çfarë kishte ndodhur në natën mes 27 dhe 28 shtatorit 2007, kur viktimat ishin sulmuar në pusi nga **A.D.1.** dhe **A.D.2.**, me dikë tjetër, të gjithë të armatosur me Kalashnikov¹¹.

Sa për S.Q. edhe ai i tha gjykatës se pse dhe në çfarë mase ai kishte qenë i përfshirë në ngjarjet e natës kritike¹². Ai ndodhi që të takohej me kolegun e tij B.H. (ata të dy ishin zyrtarë policorë) dhe ishte i bindur se B.H. dhe disa djem të tjerë ishin duke shkuar për ta vranë atë, pasi ai pa, në

thirri mua dhe më pyeti se ku isha. Unë i tregova atij se ku isha dhe ai më pyeti nëse **T.** ishte me mua dhe unë u përgjigja, jo. E pyeta nëse ai ishte me **A.D.2.** dhe ai u përgjigj, po. Unë i thashë, "Thuaj **A.D.2.** që çelësat e veturës janë në restorantin Evropa." Ai më pyeti nëse e kisha veturën e **A.D.2.** dhe unë i thashë, po. Ai u përgjigj: "Më sillni veturën në pompën e benzinës Xhafa". E mora veturën e **A.D.2.** dhe S. mu bashkua dhe shkua në Pompën e Benzinës Xhafa. Kur arrita atje e vërejtta veturën e **N.C.**, me dritat e ndezura. Unë u ndala dhe u largova nga vetura. Shkova pas ndërtesës së pompës së benzinës ku ishin parkuar disa kamionë. Aty i pashë të gjithë të katërtit prej tyre të armatosur, **A.K.**, **N.C.**, **A.D.2.** dhe **A.D.1.** Ata kishin veshur dorëza dhe një lloj kapele, e që më vonë dolën të jenë maska. E pyeta **N.C.** "A deri këtu paska ardhur puna a?" Ai u përgjigj: - Unë i di punët e mia. I kërkova që mos të del në vend të ndriçuar se unë isha me një shok. Ai më pyeti me kënd. I thashë me S.Q.. Ai tha - pse e ke sjellë atë copë muti, një spiu në UNMIK-ut këtu. A ka adhur këtu për të bërë hetime, laroje prej këtu. **A.D.1.** tha-po, e pashë atë. Në atë moment ata i vunë maskat. **N.C.**, e kishte vënë një maskë pak më ndryshe. Ishte një maskë ushtarake, ngjyrë kafe. Ai shkoi te vetura, unë vazhdova dhe u ktheva brenda në **xxxxxx**. Ata u nisën para nesh dhe ne i ndoqëm pas. Unë shkova nën urë duke udhëtuar drejt Restorant Mani dhe ata shkuan mbi urë drejt Varrezave të Dëshmorëve. Gjersa ishim në pompën e benzinës, ata duke qenë të armatosur, **N.C.**, më tha, "Shko tek Restorant Mani dhe tregoji M. të më jep shenjë dhe gjaku po më vlon." Unë fillimisht shkova në Ida Petrol që ta dërgoja S.Q., dhe i thashë atij- më duhet të shkoj përsëri në Restorant Mani se më duhet ta shoh dikë. Së bashku me S.Q. unë shkova në Restorant Mani dhe hyra brenda. E takova A. dhe T. dhe u ula pranë A.. E vërejtta N. në një tavolinë tjetër dhe e përsëndeta. Nuk e di nëse S.Q. u ul sepse ai nuk ishte në marrëdhënie të mira me M.. Sapo u largua S.Q. unë i thashë M., " **N.C.** më kërkoi që t'iu them që të shkosh dhe t'i jepnit shenjë atij në urë."

10

Sinjalet mu treguan, unë do t'ju them, t'i binte borisë. Unë i tregova M. dhe ai u çua dhe më tha - të lutem, a mund të shkosh ti në vend timin, sepse ata më kanë parë mua këtu dhe ata mund të jenë të dyshimtë. Unë i thashë atij, "Le të shkojmë së bashku." Ai tha: - Jo, jo ti shko vetë, unë mund të shkoj me A., por ata na kanë parë këtu. T. më tha: "Kur të arrini te ura bjeri borisë dy herë." Kështu që unë u nisa dhe hyra në automjetin **xxxxx** të **A.D.2.** dhe i thashë S.Q., "I vërejtta disa ngatërrestarë brenda restorantit, kështu që le të presim pak". Shkua te Larësja e Veturave dhe e fikëm veturën. Në ndërkohë arritën 2-3 persona që i përkisnin lagjes M.. Restoranti dhe Larësja e veturave janë të tyre. Ata më panë dhe erdhën për të më përsëndetur. Unë dola nga vetura dhe dola në anën tjetër të rrugës kryesore duke i vëzhguar ata deri sa dolën nga restoranti. Në atë minutë që ata dolën nga restoranti, unë u nisa drejt Kaçanikut. I thashë S.Q., "Do të vozis drejt pasi që ata mund të jenë të dyshimtë, pasi që ne jemi **xxxxxxx**." Unë po e ngisja veturën ngadalë. Kur arrita afër Restorant Kosovës, i cili është në anën e djathtë-në drejtim të Kaçanikut kam shikuar automjetin prapa nesh në pasqyrë për të siguruar që ata janë në rrugën kryesore. Kam vazhduar drejt deri te Varrezat e Dëshmorëve. Kam vënë re se automjeti ishte duke ardhur në drejtim të njëjtë të Kaçanikut. U ktheva në anën e djathtë drejt varrezave dhe isha duke vozitur drejt Urës së Lepencit. I rashë borisë dy herë. I rashë borisë së veturës. Pastaj u ktheva dhe vazhdova në drejtim të lagjes T. dhe D. Kur arrita në lagjen T. e vërejtta një automjet duke hyrë në një palë dyer mjaft të mëdha. Pasi e kalova lagjen T. dhe pak para se të arrinim në Lagjen D. i dëgjova të shtënat duke u gjuajtur, në fillim ishte një rafal i të shtënave nga një AK 47. Unë vazhdova në drejtim të rrugës Bukovik-Doganaj në mënyrë që të kthehesha drejt restorantit Evropa. Pak pa arritur rrugën kryesore që të çon në Brezovicë, 250 m para asaj rruge, u ndali policia. Ishte ky oficeri policor R.M. dhe unë e njoh atë **xxxxxxxxxxx**. Ai më tha - ti B.H. je a? E pyeta - çfarë ka ndodhur? Ai u përgjigj: - ka pasur disa të shtëna me armë zjarri dhe ai vazhdoi. Pak para se të arrinim te **xxxxxxxxxxx** aty kishte ndodhur një aksident me makinë, ne u ndalëm atje dhe në fillim mendova se ishte **N.C.** **xxxxxxx**, ne vazhduam. Unë e ndala S. te Ida Petrol, ku automjeti i tij ishte parkuar. Pastaj e lashë automjetin e **A.D.2.** në restorantin Evropa dhe mora veturën time. S.Q. kishte një **xxxxxxx** dhe ai e mori veturën. Ai vazhdoi në drejtim të shtëpisë së tij. Unë shkova në Restorant Evropa dhe e lashë veturën e **A.D.2.** dhe çelësat gjithashtu dhe e mora veturën time dhe shkova në shtëpi. Kjo është ngjarja që ndodhi, unë u takova me **N.C.**, **M.**, **A.D.1.**, S.Q. dhe A.. Unë nuk u takova me **A.D.2.**, pasi që ai ishte në stacion policor. Ai është marrë në paraburgim në mëngjes. E thirra S.Q., gjë që ma kërkoi **N.C.**. Atë që e folëm ishte se unë tashmë e dija se këta 4: A., **A.D.1.**, **A.D.2.** dhe **N.C.** ishin të armatosur dhe se ata dolën jashtë. Të nesërmen ne u pyetëm nga **N.C.** për shkak të alibisë dhe për shkak se **A.D.2.** ishte në polici dhe ai tha - ai shoku i juaj na e bëri këtë. Ai (**A.D.2.**) tha: "B.H., ju e dini se unë isha duke ngrënë një sanduiç dhe ju e dini se si **N.C.** më mori me forcë." Ai tregoi dhe e përshkroi rrugën se si ata shkuan me një automjet **xxxxx**. Ai e mori **A.D.1.** dhe **N.C.** me automjetin e njëjtë. U nisën në rrugën kryesore nga shtëpia apo nga pompa e benzinës në drejtim të vendit të ngjarjes dhe ai deklaroi se ai u largua nga këto dy aty dhe mori një kthesë të majtë drejt një drejtimi të panjohur për mua. Më tej ai deklaroi se nuk ishte në gjendje për të kontaktuar me ta, sepse ata i kishin fikur telefonat e tyre. Ishte vetëm kur ai ishte njoftuar nga F.C., në mënyrë që të shkoste dhe t' i merrte ata.

11

A.D.2. kishte shpjeguar Ai i mori ata (që do të thotë **N.C.** dhe **A.D.1.**) me **N.C.** **xxxxxxx**. Ai tha gjithashtu se si çoi ata dhe se si ai i la ata në fermë dhe në urën e Lepencit dhe se si i çoi ata në fermë. Është interesante se në natën kritike në orën 23:00, **N.C.**, **A.D.1.**, **A.K.** dhe **A.D.2.**, në momentin kur ata u nisën nga pompa e benzinës X ai më tha: "ata ishin të armatosur", dhe se ata kishin maska dhe se ai i la ata në urë të armatosur".

12

Shih procesverbalin e seancës 8 nëntor 2012.

mes tjerash, **A.D.1.** të armatosur me Kallashnikov. Pastaj, në Restorant Mani, ai e mori vesh se B.H. ishte duke i kontrolluar lëvizjet e N.B., duke e ngarë veturën në të cilën gjendeshin njerëz të tjerë. Ishte në rrugën për në Kaçanik dhe pikërisht në urë që B.H. i ra borisë dy apo tri herë, duke e bërë atë të pyes veten pse. Pas kësaj ata dëgjuan disa të shtëna dhe u ndaluan nga një polic (R.M.), i cili ishte duke patrulluar zonën. Ishte vetëm gjatë paraburgimit të tij në burgun e Dubravës që ai pati rastin të fliste me **A.D.2.**, i cili i bëri një vizitë B.H. së bashku me disa nga të afërmit e këtij dëshmitari, dhe t'i thuhej se kush ishte përgjegjës për vrasjet dhe vrasjet në tentativë¹³.

Deklaratat e dëshmitarëve të tjerë

N.K. dhe **A.K.** ishin marrë në pyetje në lidhje me çështjen e veturës, e cila iu kishte shitur A.K. dhe iu kishte kthyer prapë N.K., për shkak se mungonin disa nga dokumentet e regjistrimit. K. kujton disa takime me të, mes tjerash, me **N.C.**, N.B. dhe B.H. me qëllim që ta bënin atë që t'ia kthente paratë A.K. As Prokurori as dëshmitari nuk sqaruan se në çfarë mase duhet t'i referohet këtij elementi në aktakuzë ashtu siç ai është në këtë procedurë, pasi që **N.C.** është akuzuar vetëm me akuzën dy. A.K. dha vetëm mendimin e tij, por asnjë provë për përfshirjen e **A.D.2.** dhe **A.D.1.** (të akuzuar me akuzën një) në lidhje me çështjen e veturës. Duhet të shtohet se trupi gjykues nuk e konsideron të besueshme dëshminë, si rezultat i qëndrimit të tij negativ ndaj gjykatës dhe palëve. Ai e arsyetoi jo gatishmërinë e tij për t'iu përgjigjur disa pyetjeve me kërcënimet e supozuara të marra nga **N.C.**, por ai nuk arriti t'i raportojë ato në polici dhe prokurori, duke ngritur dyshime mbi vërtetësinë e deklaratave të tij dhe marrëdhëniet me të pandehurit, gjithashtu.

B.B. ishte marrë në pyetje gjatë seancës së mbajtur më 20 prill 2012, kur ai tha se atij i kishin treguar disa miq, të cilët kishin shkuar për ta vizituar atë kur ishte i shtruar në spital dhe gjatë periudhës së shërimit¹⁴. Ky dëshmitar /palë e dëmtuar i referohet vetëm thashethemeve njëjtë si Y.B. (babai i N.B.), A.B. (vëllai i S.B.) dhe M.B. (babai i U.B.). Y.B. i tha Gjykatës se njëri prej djemve të tij (nuk është e qartë nëse ai ishte viktima, N., apo B.B. apo të dy), kishte pasur disa 'mosmarrëveshje' me A.D.2., por ai nuk mund të jepte asnjë detaj në lidhje me ta¹⁵. Të dy B.B. dhe M.B. i ngritën dyshimet e tyre mbi **A.D.1.** dhe **A.D.2.**, pasi që të pandehurit iu kishin

¹³ B.H., **A.D.2.**, **B.H.**, vëllai i B.H., dhe gjithashtu A.H., i afërm i B.H., ishin aty gjersa unë isha në një dhomë të veçantë me vëllain tim, M.Q. dhe unë dhe vëllai im kaloi ca kohë, disa minuta së bashku dhe atëherë kemi hyrë vizita në mes B.H. dhe të tjerëve ishte mbajtur. Gjatë bisedës e cila ndodhi aty, **A.D.2.** në 2-3 raste ia përmendi B.H. - Ne ju kemi mashtruar juve. Ai tha, "Unë nuk e di se si ne do ta zgjidhim këtë çështje, por unë jam në pozitë, por këtë herë ai është biri i axhës sim, i cili është i përfshirë dhe ai që qëllon për të cilën ai na kishte vënë të gjithëve në barrë dhe ne duhet të jem një lloj zgjidhje. Unë nuk e di nëse ne duhet të shkojmë te Prokurori Publik, sepse unë jam marrë shumë në rrezik 'Ai filloi duke dhënë sqarim lidhur me rastin dhe i tha: B.H.- Ju e dini shumë mirë se si ishin gjërat, unë isha duke ngrënë një sanduiç, kur ata më morën mua. B.H. tha- të jeni të kujdesshëm pasi që ju jeni në dijeni se ju kam dërguar një mesazh përmes një të afërmi që ata janë gati për të vrapë ty. Unë e di këtë, sepse në disa raste **N.C.** i ka thënë B.H. për të gjetur një zgjidhje për këtë, ne duhet ta vrasim **A.D.2.** dhe arsyeja është sepse ai po sillet me A.B., i cili është një i afërm i viktimave dhe ai është i vetmi ai i cili mund të na fusë në qoshe. B.H. tha: "Unë ju thashë se ju jeni në rrezik dhe tani ju vendosni për veten tuaj." Për diçka që nuk kemi qenë në dijeni **A.D.2.** i shpjegoi ato gjatë asaj vizite. Për shembull, thirrja telefonike, e cila ishte bërë nga telefoni i F.C., duke e thirrur Restorant Evropën. Ai gjithashtu na tha se pasi e kishin kryer veprën penale ata kishin shkuar te ferma në xxxxxx. **A.D.2.** erdhi për të vizituar dhe ai zbuloi për ne gjëra të cilat ne nuk ishim në dijeni më parë gjërat që **N.C.** nuk na i tregoi dhe gjërat që ne i kemi mësuar nga **A.D.2.** janë; thirrjet telefonike të bëra nga ferma në Hotel Evropa me telefonin e F. ku **A.D.2.** ishte duke thënë: "Eja dhe merre **A.D.1.** dhe **N.C.**." Së dyti, si **A.D.2.** shkoi dhe e mori **N.C.** dhe **A.D.1.** vetëm me A.K., sepse të dytë shkuan për t'i marrë ata. Gjithashtu, para se ata ta kryenin veprën penale ai e përshkroi shtëpinë ku ata i mbushnin karrikatorët me plumba. Ai tha - ne i mbushnim karrikatorët me plumba në shtëpinë e **N.C.** Unë nuk do ta mbrojtë askënd më dhe unë do të shkojmë direkt te Prokurori Publik dhe do ta zbuloj këtë.

¹⁴ Shih deklaratat e dhëna nga B.B. 20 prill 2012, faqe 11.

¹⁵ Shih faqen 15, Seanca e 20 prillit 2012 deklaratat e dhëna nga Y.B..

"shmangur" atyre pas natës kritike dhe nuk iu kishin shprehur ngushëllime. A.B., gjithashtu i tha gjykatës lidhur me dyshimet e tij, iu referua R.T. si dëshmitar gjatë gjykimit të kaluar, i cili kishte qenë i kërcënuar: " *R.T. di për rastin. Ai është duke u kërcënuar drejtpërdrejt nga familja e N.C.*"¹⁶.

Vlen të përmendet se R.T. ishte një dëshmitar okular dhe se Gjykata e Qarkut e Prishtinës e bazoi në masë të madhe vendimin e saj në atë që ai e kishte thënë edhe në Prokurori edhe në Gjykatë gjatë gjykimit. Duke marrë parasysh atë që është shkruar në vendimin e lëshuar nga Gjykata, është për tu theksuar se ai nuk e përmend askënd tjetër, por dy njerëz në vendin e ngjarjes, të identifikuar si B.H. dhe S.Q.. As dy policët që patrullonin në vendngjarje atë natë, N.A. dhe R.M., nuk e kishin parë **A.D.1.** dhe **A.D.2.** në rrugën për në urën e Lepencit.

S.D.: ishte në detyrë në natën kritike me **A.D.1.** në S.F.. Ai tha se ai nuk mund ta gjente të pandehurin në orën 23.30 dhe se ai e kishte pritur atë që do të vinte për rreth 15 minuta. Këto deklarata mund vetëm të ngrejnë një dyshim në lidhje me rolin e luajtur nga **A.D.1.** gjatë natës kritike, por ato nuk mund të konsiderohen prova të mjaftueshme për të gjetur të pandehurin fajtor për veprat penale me të cilat ai ka qenë i ngarkuar. Siç është thënë në fillim, aktakuza e ngritur nga Prokuroria është bazuar në deklaratat e B.H., S.Q. dhe të cilët kishin mundësi për të folur me ta pas vendimit të shkallës së parë të lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës. Të gjithë ata kanë qenë të ftuar dhe ishin marrë në pyetje si dëshmitarë.

B.H., F.H. (vëllezërit e B.H.), F.H. dhe A.H. (kushërinjtë e B.H.)¹⁷ thanë të kenë folur me të afërm të tyre, të cilët iu kishin thënë atyre se nuk ishte ai i cili kishte kryer vrasje, por të pandehurit **A.D.1.** dhe **A.D.2.**, të detyruar nga **N.C.**. Sipas tyre **A.D.2.** kishte pranuar të ketë qenë një nga pjesëmarrësit, e kishte shpjeguar rolin e **A.D.1.** dhe motivi që **N.C.** kishte për ta vrarë **N.B.**. Megjithë gatishmërinë e tij për të hedhur dritë, të treguar në fillim, **A.D.2.** refuzoi të flasë me Prokurorinë, sepse ai kishte frikë nga **N.C.**.

Kujtesa e njëjtë e zhvillimeve që pasuan vendimin e lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës është dhënë nga vëllai i S.Q., M.Q., i cili foli me të, gjithashtu gjatë paraburgimit të tij në burgun e Dubravës¹⁸.

Përmbajtja e deklaratave të dhëna nga të afërmit e B.H. dhe S.Q. lejuan panelin për të gjetur të provuar se: pas vendimit të lëshuar më 7 shkurt 2011 nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, ku ata kishin qenë shpallur fajtor dhe dënuar me afat- burgim afatgjatë, B.H. dhe S.Q. vendosën të hedhin dritë mbi veprat penale me të cilat ishin të ngarkuar dhe i treguan disa të afërme të tyre se çfarë kishte ndodhur me të vërtetë gjatë "natës kritike". Është e padiskutueshme se ata kishin disa takime me anëtarë të familjeve të tyre gjatë paraburgimit në burgun e Dubravës (siç është thënë nga M.Q., F.H., A.H., B.H. dhe F.H.) dhe se si rezultat këta njerëz të gjithë u përpoqën të mbështesnin B.H. dhe S.Q., të zbulonin të vërtetën dhe t'i bënin ata që në të vërtetë ishin të përfshirë në vepra penale, nga perspektiva e tyre, t'i pranonin përgjegjësitë e tyre.

¹⁶ Shih procesverbalin e seancës së mbajtur më 20 prill.

¹⁷ Shih procesverbalin e seancës së mbajtur më 4 qershor 2012 dhe 12 nëntor 2012.

¹⁸ Shih procesverbalin e seancës së mbajtur më 12 nëntor 2012.

Përveç disa mospërputhjeve jo të rëndësishme për rastin, të gjithë të afërmit e dy dëshmitarëve kryesorë i rikujtuan takimet, përmbajtjen e bisedave dhe se kush ishte i pranishëm në të njëjtën mënyrë dhe ato mund të konsiderohen si të vërtetuara. Çfarë është konstatuar është se **A.D.2.** foli me B.H. dhe të afërmit e tij dhe se kishte një takim në zyrën e Tahir Recajt (avokati mbrojtës i B.H.) me B.H.1., A.H., M.Q. dhe **A.D.2.**¹⁹.

Çfarë nuk mund të llogaritet si e provuar është përmbajtja faktike e të gjitha bisedave të cilave iu referohen dhe pranimet e pohuara të përgjegjësive nga të pandehurit **A.D.2.** dhe **A.D.1.**, gjersa nuk është kontestuar se të paktën **A.D.2.** ka pasur takime me B.H., S.Q., B.H.1., A.H. dhe M.Q. që kishte për qëllim që ta bindnin atë që të pranonte përgjegjësinë e tij.

As ndonjë provë e rëndësishme nuk doli nga deklaratat e dëshmitarëve të cilët u takuan me të pandehurit në restorant Evropa dhe Mani vetëm para vrasjeve dhe tentim vrasjes.

M.D.²⁰ rikujtoi se ku shkoi ai gjatë natës së 27 shtatorit 2007 dhe me keni u takua, por ai nuk ka thënë (dhe as kishte thënë gjatë hetimeve) të vetmen gjë që mund të ketë qenë i një rëndësie nga perspektiva e Prokurorisë, pasi ai e mohoi t'ia ketë dhënë B.H. çelësat e **xxxxxx** që i përkiste **A.D.2.**, siç u tha nga A.A..

A.A.²¹ u takua me **A.D.2.** dhe **A.D.1.**, gjatë natës mes 27 dhe 28 tetorit (pasi u konfrontua nga Prokurori me deklaratat e dhëna gjatë hetimeve). Pak kohë më pas ai kishte një bisedë me B.H. dhe u tha se çfarë kishte ndodhur në urën e Lepencit, çfarë kishte bërë H. dhe kush kishte qëlluar në viktimat. Ai gjithashtu kishte rastin që të fliste me **A.D.2.**, i cili mohoi çdo përgjegjësi për vepra penale dhe i tha atij se ai vetëm e kishte çuar me automjet **A.D.1.** për në "vendin ku ka ndodhur vrasja".

Deklaratat e të pandehurve.

Të dy, edhe **A.D.1.** edhe **A.D.2.** mohuan të kishin marrë pjesë në vepra penale, por pranuan se ata ishin andej pari së bashku gjatë mbrëmjes së 27 shtatorit 2007, në veturën e **A.D.2.**, një **xxxxx**. **A.D.1.** tha se nuk mund t'i kujtohej nëse ai ishte në ndërrim (në detyrë) atë natë, por se nuk ishte e pazakontë që t'i shkëmbente ndërrimet me kolegët e tij.

A.D.2. konfirmoi se ai i kishte bërë një vizitë B.H., kur ai u paraburgos në burgun e Dubravës, me B.H., A.H. dhe M.Q. dhe se ata atje ishin përpjekur për ta bindur atë për të marrë përgjegjësinë e vrasjeve dhe tentim vrasjes. Më pas ai ishte detyruar që të shkonte në zyrën e avokatit mbrojtës Tahir Recajt, ku ai pati mundësinë për të dëgjuar një bisedë telefonike mes avokatit dhe prokurorit të emëruar në rast, që, në atë kohë, përfshiheshin B.H. dhe S.Q.. Gjatë ditëve në vijim ai ishte marrë në pyetje nga Prokurori Publik dhe kishte dhënë deklaratat që nuk ishin pranuar nga ky Panel, sepse i pandehuri ishte marrë në pyetje para aktvendimit për fillimin e hetimeve (AFH). Prokuroria ishte duke ndjekur drejtimin e dhënë nga B.H., S.Q. dhe të afërmit e tyre, por ai drejtim nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe arsyeja pse Prokuroria mori si të vërteta fjalët e tyre, pavarësisht mungesës së dëshmi mbështetëse nuk është sqaruar gjatë gjyqimit.

¹⁹ Shih deklaratat e dhëna nga këta dëshmitarë.

²⁰ I marrë në pyetje gjatë seancës së mbajtur më 13 korrik 2012.

²¹ Shih procesverbalin e seancës së mbajtur më 22 tetor 2012.

Konkluzionet për akuzën 1:

Është mendimi i panelit se akuzat e paraqitura kundër **A.D.2.** dhe **A.D.1.** nuk janë të bazuara, pasi Prokuroria dështoi të paraqesë prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajin e tyre. Padia është e bazuar vetëm në përmbajtjen e deklaratave të dhëna nga dy persona, të dënuar në një gjykim përfundimtar për veprat penale të njëjta (S.Q. dhe B.H.) dhe nga S.D., i cili nuk e kishte parë **A.D.1.** në postin e tij të sigurimit në natën kritike. Pastaj A.A. tha para gjykatës se M.D. ia kishte dorëzuar B.H. çelësat e makinës së **A.D.2.**, por M.D. e mohoi ta kishte bërë atë. Deklaratat e dhëna nga të gjithë dëshmitarët e tjerë të marrë në pyetje gjatë gjyimit kryesor (B.H., M.Q., A.H., F.H., A.A. dhe F.H.) janë asgjë më shumë se deklarata indirekte. Këta dëshmitarë nuk ishin në vendin e ngjarjes dhe ata rikujtonin vetëm atë që ua kishte thënë B.H. dhe S.Q.. As A.K. dhe as N.K. nuk kishin parë asgjë drejtpërdrejt, pasi ata folën vetëm për çështjen e automjetit, që supozohet të jetë motivi i veprave penale nga perspektiva e prokurorisë, por të pamjaftueshme për t'i bazuar akuzat e paraqitura në këtë rast. Të dy këta dy dëshmitarë nuk ishin në gjendje të thonin se në çfarë mase **A.D.2.** dhe **A.D.1.** kishin qenë të interesuar dhe të përfshirë në shumën e parave që N.K. dhe i ndjeri N.B. (të cilët e kishin marrë përsipër borxhi) duhej t'ia kthenin A.K..

Është për t'u theksuar se hetimet ndaj këtyre dy të pandehurve ishin hapur jo vetëm në bazë të deklaratave të B.H. dhe S.Q., dhënë Prokurorit pas gjyimit kryesor të lartpërmendur, por se çdo provë tjetër që kanë qenë ndonjëherë e mbledhur kundër **A.D.2.** dhe **A.D.1.** para se B.H. dhe S.Q. të vendosnin të flisnin me Prokurorin. Për më tepër, pyetja se pse këta dy dëshmitarë nuk ka thënë asgjë gjatë hetimeve dhe pse ata ndryshuan mendje, vetëm pas marrjes së burgimit afatgjatë, gjersa aktgjykimi i shkallës së parë ende nuk kishte marrë formë të prerë, mbetet pa përgjigje.

Me qëllim të këshillimit lidhur me akuzat e paraqitura kundër të pandehurve, trupi gjykues gjithashtu ka marrë në konsideratë provat e mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor kundër B.H. dhe S.Q. dhe aktgjykimin përfundimtar të lëshuar nga Gjykata Supreme më 24 shtator 2012. Para Kolegjit të shkallës së parë një dëshmitar okular tha se ai i kishte parë vetëm dy njerëz në vendin e ngjarjes dhe, bazuar në deklaratat e tij dhe provat e tjera, ai Paneli i konsideroi si të dëshmuara se këta dy njerëz ishin S.Q. dhe B.H.. Gjatë kësaj seance kryesore dëshmitarët kanë folur për rolin e luajtur nga të akuzuarit **A.D.1.** dhe **A.D.2.**, por prapëseprapë fjalët e tyre kanë ngritur dyshime dhe nuk mund të vlerësohen si dëshmi të mjaftueshme për t'i shpallur të pandehurit fajtorë.

Në pajtim me nenin 3 paragrafi 2 të KPPK-s çfarëdo dyshimi lidhur me "ekzistencën e fakteve relevante për rastin apo dyshime në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit penal të caktuar do të interpretohet në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij ose të saj sipas këtij Kodi" dhe në pajtim me nenin 390 paragrafi 3 të KPPK gjykata merr aktgjykim për të liruar të akuzuarit, nëse, "nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën ai ose ajo ka qenë i ngarkuar".

Konkluzione për akuzën 2:

Duke iu referuar akuzës 2 konsideratat janë të njëjta si për akuzën 1. Vlen të përmendet se B.H. dhe S.Q. kanë thënë para kësaj gjykate t'i kenë parë të pandehurit të armatosur, por askush tjetër nuk i ka mbështetur deklaratat e tyre dhe as Prokurori nuk ka mundur të provojë se ata nuk kishin

parë armë zjarri të rreme. Çfarë dëshmitari A.A., tha gjatë dëshmisë së tij nuk është e mjaftueshme për të gjetur të pandehurit fajtorë, sepse ai ka raportuar një bisedë me B.H. dhe ai vetë nuk e kishte parë N.C. dhe A.D.I. të armatosur. Kanë qenë të nevojshme prova të tjera se sa deklaratat e B.H. dhe S.Q. për ta bindur gjykatën se të pandehurit ishin të armatosur me të vërtetë, sepse këta dy dëshmitarë janë gjetur fajtorë në një gjykim të formës së prerë për vepra të njëjta penale dhe kjo është një arsye për besueshmërinë në të qenit të hapur në pyetje.

Siç është theksuar më parë, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk është shumë i mbështetur nga dëshmi në dosje dhe se në këtë rast penal Prokuroria ka dështuar për t'ia mundësuar trupit gjykues që të arrijë përfundime përtej dyshimit të arsyeshëm lidhur me fajësinë e të akuzuarve për secilën pikë.

Pasi të akuzuarit nuk janë gjetur fajtorë, shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 99 të KPPK, do të paguhet nga mjetet buxhetore, si për normat në fuqi.

Nuk është ngritur asnjë kërkesë pronësore juridike, prandaj asnjë vendim nuk mund të lëshohet.

Për të gjitha këto arsye u vendos si në dispozitivin e mësipërm.

Kryesues i trupit gjykues
Laura LIQUORI

Anëtar e trupit gjykues
Fllanza Kadiu

Anëtar e trupit gjykues
Mariola Pasnik